



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr. 1761/1 Prot.

Tiranë, më 11.3.2020

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Kreu V – "*Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*", nenit 25, "*Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive*" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", i ndryshuar, Kreu VII, Njësia Përgjegjëse e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se;

Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur brenda afateve të përcaktuara, shpall Listën e Kandidatëve, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta dhe që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën "*Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive*", për 4 (katër) vende të lira pune, të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm në pozicionin, Specialist në Sektorin e Arkiv-Protokoll dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë në ILDKPKI si më poshtë;

1. Blerina Semanjaku

Nisur nga situata aktuale në lidhje me COVID-19 dhe pikës 2, gërma c) të Urdhërit nr.156, datë 10.3.2020 të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për "*Ndalimin deri më datën 3.4.2020 të Procedurave të konkursit për punësim personeli, konkurse shkollimi dhe specializimi*", ju bëjmë me dije se Konkurrimi- testimi me gojë i planifikuar në datën 23.3.2020, në mjediset e ILDKPKI, në orën 10.00, do të shtyhet deri në një njoftim të dytë për datën e zhvillimit të tij.

Njësia Përgjegjëse njofton se, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur për procedurën "*Lëvizja paralele*", rezulton se ka ende vende vakante në pozicionin Specialist në Sektorin e Arkiv-Protokoll dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë në ILDKPKI.

Për sqarime mund të kontaktoni në adresën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga "*Reshit Çollaku*", Tiranë.

**ILDKPKI
NJËSIA PËRGJEGJËSE**